



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr. 1663/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbare të kreditorit DPT “Favor” me pronar A.D., me seli në Vushtrri, kundër debitorit N.T.N ”Venera” me NUI: 8022198577, me seli në Malishevë, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.58/22 të datës 30.06.2023, me datë 16.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit N.T.N ”Venera” me seli në Malishevë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. KPPP.nr.58/22 të datës 30.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. KPPP.nr.58/22 të datës 30.06.2023, ka Refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit N.T.N ”Venera” me seli në Malishevë ndaj Urdhrit Përmbare P.nr. 342/16, i lejuar me datë 13.10.2016, nga Përmbaresi Privat Atip Mustafa, dhe Urdhri Përmbare P.nr. 342/16, i lejuar me datë 13.10.2016, nga Përmbaresi Privat Atip Mustafa, mbetet ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 58/22 të datës 30.06.2023

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori kreditorit DPT “Favor”, me seli në Vushtrri, me dt. 24.06.2008, ka paraqitur propozim për përmbaremore në bazë të dokumentit të besueshëm faturë nr. 687473 e datës 10.08.2006, faturë nr. 687474 e datës 15.08.2006 dhe faturë nr. 687475 e datës 28.08.2006 me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit që rrjedh nga kjo faturat e lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën prej 12,314.40 EUR (dymbëdhjetë mijë e treqind e katërbëdhjetë euro e katër dhjetë euro cent) me kamatë ligjore prej 3% duke filluar nga data 06.09.2006 deri në pagesën e plotë si dhe shpenzimet e përmbaremit, nën kërcënim të përmbaremit të dhunshëm. Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbaremore me arsyetimin se debitori nuk ka hyrë asnjëherë në marrëdhënie juridike civile me kreditorin dhe se faturat në fjalë asnjëherë nuk i ka pranuar, fakt ky që dëshmohet nga mungesa e nënshkrimit të debitorit në këto fatura. Tutje ka shtuar se faturat kanë të meta pasi që nuk figuron numri fiskal dhe as ai i biznesit të debitorit dhe pranuesit të mallit, andaj të njëjtat nuk janë të përshtatshme për përmbaremore. Me kërkesë që prapësimi të aprovohet, ndërsa Urdhri Përmbaremore E.nr. 155/2008 i datës 24.06.2008, tanimë i identifikuar me shenjë P.nr. 342/16 të lihet jashtë fuqie. Po ashtu Kreditori, në përgjigjën në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit duke theksuar se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbaremore janë dorëzuar tek debitori me rastin e pranimin të mallit, dhe se faturat janë nënshkruar nga Latë Latifi, i cili ka qenë ortak-aksionar së bashku me debitorin, dhe ka pasur autorizim për pranimin e mallrave në emër të debitorit. Ka shtuar se debitori edhe në të kaluarën ka porositur mallra nga kreditori, por të njëjtat i ka paguar, ndërsa ka ngelur borxh në shumën si në propozimin për

përmbarim. Me kërkesë që Prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa Urdhri Përmbarimor E.nr. 155/2008 i datës 24.06.2008, tanimë i identifikuar me shenjë P.nr. 342/16 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim: Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPPsë, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Gjykata e Shkallës së Parë në rastin konkret vlerëson se faturat nr. 687473 e datës 10.08.2006, nr. 687474 e datës 15.08.2006 dhe nr. 687475 e datës 28.08.2006 në bazë të së cilave është lejuar përmbarimi i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, kjo pasi që në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit dhe faturat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt përmes nënshkrimit të tyre.

Gjithashtu thekson se në rastin konkret faturat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal. Në këtë rast, Gjykata vlerësoj pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim por gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur pretendimet e tilla, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe ankesës së parashtruar ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit për përmbarimit.

Andaj bazuar në të lartë cekurat, dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me pretendimin e tij se propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm nuk e përmban origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm kundër urdhrin përmbarimor P.nr. 342/16, i datës 13.10.2016, për shkak se e njëjta nuk është pranuar dhe nënshkruar dhe nuk përmban vulë të debitorit, e cila dëshmon se personi kompetent e ka pranuar një faturë të tillë. Po ashtu debitori thekson se për të qen dokument i besueshëm për përmbarim duhet ti përmbaj të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-se.

Tutje shkalla e dytë thekson se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë se faturat nuk i plotësojnë kushtet për përmbarim ngase nuk janë të pranuar apo nënshkruara dhe nuk përmbajnë vulën e debitorit dhe se nuk është personi kompetent te cilat i ka pranuar këto fatura dhe për më tepër debitori nuk ka bashkangjitur asnjë provë të vetme për ti mbështetur pretendimet e tij ankimore.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi

se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më të drejt gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se debitori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K. DH.Shk II.nr. 1663/23 me datë 16.04.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti